

Nisma ndër-institucionale për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova 'Procesi i Shkupit'

Përmbledhje

Procesi rajonal i Shkupit drejtohet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) në Kosovë, mbështetur dhe lehtësuar së bashku nga Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (OSBE) dhe Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) Zyra në Kosovë. Procesi ka nisur pesë vjet më parë. Janë marrë angazhime të qarta nga përfaqësuesit e institucioneve nga Beogradi, Podgorica, Prishtina dhe Shkupi, të cilat janë pajtuar me parimet udhëzuese. Janë organizuar disa takime, janë bërë vlerësime me popullatën e zhvendosur dhe është arritur një progres i caktuar në disa fusha.



Grupi teknik i punës

Grupi punues u takua në nëntor 2019 dhe i ndihmuar nga UNHCR dhe OSBE bashkoi sektorët përkatës qeveritarë të institucioneve pjesëmarrëse, vlerësoi përparimin, zbatimin dhe përcjelljen e mundshme që do të kontribuojë më tej në zbatimin e Temave të Veprimit (Të drejtat e pronës, Siguria, Dialogu dhe Ri-integrimi, Dokumentacioni Personal, Menaxhimi i të Dhënave dhe Planifikimi i Zgjidhjeve).

Koncept Dokument për "Zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga dhe brenda Kosovës"

Anëtarët e grupit teknik të punës, njëzëri miratuan koncept dokumentin dhe ranë dakord të punojnë së bashku në krijimin e programeve gjithëpërfshirëse të zgjidhjeve të qëndrueshme:

- ✓ Të gjitha opsionet e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur do të zbatohen në mënyrë të barabartë dhe do të jenë të plota dhe gjithëpërfshirëse;
- ✓ Përmirësimi i komunikimit të rregullt dhe shkëmbimi i gjerë i të dhënave midis delegacioneve;
- ✓ Prezantimi i koncept dokumentit në 2020 në forumin e nivelit të lartë për të kërkuar mbështetjen politike dhe angazhimin e zyrtarëve të lartë për të siguruar bazë për fillimin e konferencës së donatorëve;
- ✓ Do të bëhet përmirësimi i mëtutjeshëm i koncept dokumentit, në formën e anekseve nga delegacioni.

Përmbledhje e veprimeve/konkluzioneve të dakorduara

- ✓ Fokus në zgjidhje të përshtatura dhe ndërhyrje të bazuara në zonë, përfshirë fuqizimin holistik, koherent dhe të integruar ekonomik dhe shoqëror për të promovuar arritjet e të drejtave.
- ✓ Të drejtat e bazuara, metodologjia e bazuar në nevoja dhe përparësia për adresimin e nevojave të personave të zhvendosur (qasja e përqendruar te njerëzit dhe ndjeshmëria gjinore) u dakordua ashtu siç u përshkrua tashmë në dy raportet "Situata dhe nevojat e personave të zhvendosur" dhe "Personat e zhvendosur nga Kosova në rajon - një rivlerësim i interesit për t'u kthyer".
- ✓ Sigurimi i një mbështetje transparente, pjesëmarrëse dhe të strukturuar për të

intensifikuar përfshirjen e personave të zhvendosur në iniciativën rajonale;

- ✓ Fletushkë me informacion praktik të përgatitur nga OSBE do t'u shpërndahe personave të zhvendosur për të sjellë një informatë zgjedhëse për kthim, si një nga zgjidhjet e qëndrueshme;
- ✓ Delegacionet (më saktë MKK) është e nxitur të shikojë që të jenë në dispozicion të dhënave dhe modalitetet e mundshme të shkëmbimit të të dhënave pa vonesë të mëtejshme, i cili mbetet një parakusht i rëndësishëm për të përcaktuar më tej rrugën përpara drejt programeve të zgjidhjeve dhe mbledhjen e fondeve përmes një konference donatorësh. MKK pret disa rezultate konkrete në lidhje me krijimin e sistemit të administrimit të të dhënave para konferencës së ardhshme.
- ✓ Delegacionet janë pajtuar që praktikën e mirë nga Strategjia Gjithëpërfshirëse Rajonale e Zgjidhjeve të Qëndrueshme (e njohur zakonisht si "Procesi i Sarajevës") që janë të zbatueshme për procesin e Shkupit duhet të përfshihen në punën e ardhshme të përbashkët të paraparë në Koncept Dokumentin e përbashkët.
- ✓ Me një rëndësi të veçantë, të gjitha delegacionet duhet të konsiderojnë Agjendën e Qëllimit e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030, e drejtuar globalisht për të gjitha autoritetet, e cila bën thirrje për promovimin e parimit "askush të mos lëhet prapa", dhe mjedisin adekuat të mbrojtjes.
- ✓ Në periudhën e ardhshme, OSBE dhe UNHCR do të ndihmojnë në organizimin e takimit për dokumentacionin personal për personat të cilët janë caktuar si pikë referuese në nivelin teknik për të diskutuar temat specifike.

Informacioni publik / shfaqja e videove gjatë ngjarjes, e përqendruar në mbrojtjen e personave të zhvendosur dhe të kthyerve

Dokumentar nga OSBE "Të jesh përsëri në shtëpi":

- <https://www.youtube.com/watch?v=gyRVWVW56CI> (Versioni në gjuhën angleze)
- <https://www.youtube.com/watch?v=zpAQGTK3iIs> (Versioni në gjuhën shqipe)
- https://www.youtube.com/watch?v=c2_FZSJY-3c (Versioni në gjuhën serbe)

Videot e UNHCR-së (në dispozicion në faqen zyrtare në Facebook, UNHCR Kosovo):

- #Ibelong video (publikuar më 26.11.2019)
- Pazari me gjëra artizanale i bërë nga persona të zhvendosur (publikuar më 14.10.2019).

Shkurt 2020